

Tabela Përmbledhëse

1.	PËRSHKRIMI I PËRGJITHSHËM DHE KONCEPTI	4
1.1.	HISTORIKU	4
1.2.	OBJEKTIVAT E PROJEKTIT	5
1.3.	KUADRI LIGJOR	7
1.3.1.	PËRSHKRIMI I GJENDJES EKZISTUESE.....	8
1.3.2.	Konteksti urban	8
1.3.3.	Objekti Shtesë	9
1.3.4.	Ambientet e brendshme.....	10
2.	EVIDENTIMI I PROBLEMATIKAVE DHE NDËRHYRJET E PROPOZUARA	11
2.1.	PROBLEMATIKAT E EVIDENTUARA	11
2.1.1.	Plansistemimi	11
2.1.2.	Planet	11
2.1.3.	Fasada	14
2.1.4.	Konstruksioni.....	18
2.2.	NDËRHYJET E PROPOZUARA.....	19
2.2.1.	Plansistemimi	19
2.2.2.	Planet	20
2.2.3.	Restaurimi i fasadave.....	22
3.	ZHVILLIMI I RI	25
3.1.	KONCEPTI PËR "MUZEUN E RI".....	25
3.2.	ZGJIDHJA URBANE.....	27
3.2.1.	Plansistemimi dhe ambientet rekreative	27
3.2.2.	Shtrimi.....	28
3.2.3.	Gjelberimi.....	29
3.2.4.	Mobilimi Urban.....	30
3.3.	ZGJIDHJA NE PLAN	31
3.3.1.	Skema funksionale.....	31

3.3.2.	Sipërfaqet e funksioneve ekzituese dhe atyre propozuese	32
3.3.3.	Hyrja dhe levizjet	33
3.3.4.	Ekspozimi.....	34
3.3.5.	Administrata	34
3.3.6.	Konservim Dixhitalizimi	35
3.3.7.	Ambientet kulturore	38
3.3.8.	Dyshemetë	38
3.3.9.	Tavanet.....	39
3.3.10.	Ndriçimi.....	39
3.3.11.	Muret e brendshme	41
3.3.12.	Mbrojtja ndaj zjarrit	41
3.4.	ZHVILLIMI VOLUMETRIK.....	41
3.4.1.	Muret perimetrale.....	41
3.4.1.	Vetratat e jashtme.....	41
3.4.2.	Tarraca	43
3.4.3.	Imazhe 3Dimensionale	44

ABSTRAKT

Sipas propozimit tonë godina kryesore ekzistuese, një vlerë e rëndësishme arkitektonike dhe urbane e trashëgimisë tonë, rikonstruktohet duke nxjerrë në pah vlerat më të mira të arkitekturës moderne shqiptare të viteve '70, dhe i jep zgjidhje përfundimtare problemit aktual të ruajtjes së veprave, ekspozimit të kryeveprave të artit shqiptar e botëror, si dhe restaurimit e konservimit të tyre.

Muzeu i Ri i Arteve të Bukura, përveç ambienteve ekzistuese, propozohet të shtohen ambiente të reja konservimi dhe restaurimi, klasa ëorkshopi, salla polifunkionale, kafe-restorant dhe salla ekspozimi alternative nëpërmjet një volumi të ri. Duke unifikuar godinën e re dhe të vjetër, ne propozojmë që Muzeu i Ri i Arteve të Bukura të jetë një objekt i cili ndjehet dhe përdoret plotësisht si një godinë e shek.XXI. Ambientet e reja që i shtohen programit të Muzeut krijojnë mundësinë për mbajtjen e evente të ndryshme duke e kthyer MKAB në qendrën me të madhe kulturore aktive publike për artet pamore.

Hyrjet e reja bëhen ndërmjet godinës së vjetër dhe asaj të re, duke krijuar një holl të lartë transparent si cili lidh funksionalisht dy godinat dhe krijon mundësi për zhvillim të gjerë aktiviteteve. Fasada e pasme e godinës ekzistuese, e cila nuk njihej nga publiku, por që ka të njëjtën forcë volumore dhe veshje me mozaikë, rivlerësohet duke e kthyer në fasadë shoqëruese të hollit kryesor.

Në sajë të skemës tonë të re urbane, krijohet një arterie e re artistike e cila rrit eksponencialisht bashkëveprimin midis publikut dhe artit perfaqësues të tij si edhe bashkëveprimin midis qytetarëve nëpërmjet frekuentimit të këtij muzeu arti.

Uniteti i godinës e vjetër dhe të re, përfaqëson një institucion progresiv të kulturës, ku në mënyrë moderne dhe të qartë forcohen karakteri monumental i godinës së vjetër nga një perspektive e re e pazbuluar me parë për qytetin, sipas zhvillimit të ri të qëndresës së qytetit me kalimet pedonale të saj. Në këtë mënyrë ne forcojmë kalimet historike arkitektonike nga një periudhë tjetra duke lënë gjurmë të rëndësishme për brezat pasardhës të kujdesit të treguar për ruajtjen dhe konsolidimin e trashëgimisë tonë kulturore.

1. PËRSHKRIMI I PËRGJITHSHËM DHE KONCEPTI

1.1. HISTORIKU

Muzeu Kombëtar i Arteve të Bukura është institucion kombëtar, qendror, muzeor, studimor, shkencor, me qëllim të vetëm ruajtjen, prezantimin, promovimin e trashëgimisë kombëtare të shtetit shqiptar në fushën e arteve pamore. Objekti është institucion shtetëror në varësi të Ministrisë së Kulturës. Galeria i ka fillimet e saj me përpjekjet e një grupi artistësh shqiptarë dhe të Komitetit të Arteve të vitit 1946.

Pinakoteka ishte institucioni i parë i arteve figurative në Shqipëri. Pas një pune të mirëfilltë dhe përpjekjesh të shumta në 11 janar 1954 u hap zyrtarisht për publikun Galeria e Arteve në Tiranë. Në vitin 1956, si rrjedhojë e pasurimit të fondit të veprave të artit, prej lulëzimit të krijimtarisë dhe blerjeve të kohës, Galeria u zhvendos në godinë më të përshtatshme, me tre kate në rrugën "Fortuzi" dhe me hapësira ekspozuese të shumta, si brenda ashtu edhe jashtë saj.

Ajo ndryshoi godinë disa here. Ndertesa e re u inaugurua më 29 nëntor 1974, në Bulevardin "Dëshmorët e Kombit", ndërtesë, ku ndodhet edhe sot. Fondi i Galerisë së re, deri në këtë periudhë kishte 4626 vepra dhe në arkivin e saj ishin regjistruar më shumë se 600 autorë.

Që nga ky vit Muzeu Kombëtar i Arteve të Bukura funksionon si institucioni më i rëndësishëm dhe i vetëm kombëtar i ekspozimit, konservimit, studimit, restaurimit, edukimit, botimit, dokumentimit dhe arkivimit të veprave të artit në Shqipëri. Me datë 10.08. 1992, Galeria e Artit merr emrin Galeria Kombëtare e Arteve me këtë motivim: "Për të shprehur më mirë qëllimin dhe funksionimin e këtij institucioni si i vetëm, kombëtar që mbron dhe promovon interesat e arteve figurative shqiptare".

Muzeu Kombëtar i Arteve të Bukura, ka mision grumbullimin, koleksionimin, konservimin, dokumentimin, studimin, restaurimin, ekspozimin dhe zhvillimin e vlerave të trashëgimisë kulturore, duke promovuar veprat më të mira të artit pamor shqiptar të traditës dhe atij bashkëkohor kombëtar e ndërkombëtar.

Muzeu, gëzon statusin Monument Kulture i kategorisë së dytë. Si i tillë ky objekt mbrohet "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë" ku është spikatur kryesisht për pamjen e tij të jashtme. Gjithashtu përfshihet brenda zonës së mbrojtur "Qendrës historike të aksit kryesor të qytetit të Tiranës".



Figura 1. Pamje perspektive e objektit

1.2. OBJEKTIVAT E PROJEKTIT

Objektivat specifike të Termave të References është të sigurojnë projektin e zbatimit me objekt: "Restaurimi, rikonstruksioni dhe rehabilitimi i hapësirave në Muzeun Kombëtar të Arteve të Bukura " sipas pikave të mëposhtme:

-
- Krijimi i një hapësire të re qytetare;
- Përmirësimi i mënyrës së komunikimit me vizitorin duke rimodeluar modulën dhe lëvizjen;
- Krijimi i hapësirave për ekspozime të reja;
- Përmirësimi i sistemeve teknike;
- Zgjidhja e hapësirave të magazinimit dhe ruajtjes në kushte të përshtatshme të fondit të objekteve muzeore;
- Rritja e kapacitetit të objektit;
- Përmirësimi i komfortit termik dhe parametrave fiziko-ambiental.

Riformulimi arkitektonik i Muzeut do të përfshijë ambientet e mëposhtme:

Holli kryesor:

- Hyrja dhe vendi i grumbullimit
- Informacioni dhe biletaria
- Garderoba + depozitimi i materialeve të vizitorëve
 - Nyje higjenosanitare

Njësia e administratës :

- Riorganizimi i zyrave sipas sektorëve përkatës dhe krijimi i hapësirave efikase dhe fleksibile për stafin.
- Sallë mbledhje
- Kuzhinë
- Nyje higjenosanitare

Hapësirat e ekspozimit :

- Ekspozitë e përkohshme
- Ekspozitë e përhershme
- Depo/magazinimi i objekteve të ndryshme në funksion të ekspozitorëve

Qendra e konservimit dhe restaurimit:

- Krijimi i fondit të pikturës dhe skulpturës
- Hyrje/dalje e vecantë për transportin e koleksionit
- Hapësirë për depozitimin e përkohshëm të veprave
- Hapësirë për regjistrimin dhe fotografimin e koleksionit
- Laboratorë restaurimi për pikturën dhe skulpturën

Ambiente social -kulturore:

- Biblioteka
- Auditor
- Hapësira multi-funksionale që lejojnë mundësinë dhe kanë infrastrukturë për të marrë forma dhe trajta të ndryshme, të cilat mund ti vihen në dispozicion edhe programeve të ndryshme të edukimit;

Ambientet e shërbimit :

- Bar-caffe
- Bookshop & Souvenir

Hapësirat ndihmëse:

- Ambiente teknike
- Depo /magazinë

1.3. KUADRI LIGJOR

Projekti për Restaurimin, Rikonstruksionin dhe Riformulimin e Linjës Muzeore në Muzeun është i bazuar në:

- Ligjin Nr.27/2018, "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë";
- Parimet e "Kartës Shqiptare të Restaurimit", VKM. Nr.426, 13.07. 2007;
- VKM nr. 325, datë 12.04.2017 "Qendra Historike e Tiranës dhe rregullore";
- Vendim i zones arkeologjike A (2009).

Përveç kuadrit ligjor të mësipërm, Konsulenti do të shqyrtojë dhe të bazojë procesin dhe rezultatin e pritur edhe në dokumente të tjera të rëndësishme ligjore. Disa nga kornizat ligjore kryesore që do të merren parasysh janë të shënuara më poshtë.

- VKM nr. 2, datë 8.5.2003 "Për klasifikimin dhe strukturën e kostos në punimet e ndërtimit"
- VKM nr. 627, datë 15.7.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre"




Figura 2. Harta e qendres historike te Tiranës

1.3.1. PËRSHKRIMI I GJENDJES EKZISTUESE

1.3.2. Konteksti urban

"Muzeu Kombëtar i Arteve të Bukura " (Godina e Galerisë së Arteve) ndodhet përgjatë Bulevardit "Dëshmorët e Kombit" në Tiranë dhe përbëhet nga dy ndërtesa të lidhura mes tyre. Ndërtesa kryesore, që shihet nga Bulevardi "Dëshmorët e Kombit" e ndërtuar fillimisht në 1972 , i cili përbëhet nga 3 kate dhe një kat teknik i pjesshëm nën nivelin e tokës, me një trajtim më të pasur të fasadave, dhe ndërtesa e pasme me dy kate që është shtuar pak vite më vonë si sallë ekspozitash dhe nuk ka ndonjë trajtim të veçantë në veshjen e fasadave dhe dallohet për zgjedhjen e ashpër të cilësisë së ndërtimit.



Figura 3. Lidhja e objektit me qendren

Objekti kufizohet në perëndim me Bulevardin "Dëshmorët e Kombit", në veri me shëtitoren "Murat Toptani", në lindje nga vila e "Zogut" dhe në jug nga "Hotel Dajti". Aksesimi për hyrjen në objekt realizohet nga Bulevardi në jug-perëndim dhe nga pedonalia në veri. Evidentohen hapësira të gjelbërta, kryesisht në sheshin përpara objektit dhe më pak në pjesën e pasme të tij .



Figura 4. Pamje e objektit ekzistues dhe objektit shtesë

1.3.3. Objekti Shtesë

Objekti i ndërtuar disa vite më vonë nga projekti fillestar, është një shtesë e cila i është përgjigjur kërkesave për shtim të hapësirave ekspozuese. Ky objekt i ndërtuar ngjitur me fasadën lindore të objektit fillestar ka dëmtuar totalisht shfaqjen e kësaj fasade duke mbuluar totalisht arkitektura që ajo përfaqeson. Pjesa më e madhe e sipërfaqes së mureve perimetral të kësaj është e veshur me mozaik ,që tashmë nuk është më i dukshëm, ndërsa në katin përdhe ka humbur ideja e të pasurit një vetratë xhami siç është projektuar nga arkitektet në projektin fillestar.




Figura 5. Projekti sipas arkivës. Fasada lindore e konceptuar me vetratë xhami në katin përdhe.

1.3.4. Ambientet e brendshme

Galeria Kombëtare e Arteve është e zhvilluar në 4 kate, nga të cilat njëri është nëntokë dhe tri mbitokë. Funkcionet që zhvillohen në secilin kat pasqyrohen më poshtë:

Kati i podrumit (-1):

- Depo dhe magazina
- Ambiente teknike

Kati përdhe (kati 0):

- Hyrja
- Holli kryesor
- Administrata dhe Nhs
- Biblioteka
- Laboratori i Restaurimit
- Hapësira edukimi (atelie)
- Ekspozitë e përkohshme

Kati i parë (kati +1):

- Ekspozitë pikturë
- Fondi

Kati i dytë (kati +2):

Ekspozitë

2. EVIDENTIMI I PROBLEMATIKAVE DHE NDËRHJRJET E PROPOZUARA

2.1. PROBLEMATIKAT E EVIDENTUARA

2.1.1. Plansistemimi



Figura 6. Pamje nga sistemimi ekzistues i zonës

Aktualisht, zona në hyrje të objektit shfaqet e sistemuar me gjelbërim dhe pllaka guri , ndërkohë që hapësira e pasme e objekti është e zënë nga parkime makinash, kioska, hedhje mbetjesh dhe hapësira të improvizuara për skulptura të jashtme. Terreni ka disnivel të ndjeshëm kuotash dhe menyra të ndryshme të shtrimit, një pjesë e pllakavë të shtrimit janë të thyëra, ndërsa një sipërfaqe e konsiderueshme në oborrin e pasëm është e shtruar me zhavorr të imët. Një ndër problemet e rëndësishme që konstatohet është mungesa e sistemit të drenazhimit gjë që shkakton përmytje të hapësirave përfaqë godines dhe të podurmit në raste shirash.

2.1.2. Planet

Kati i podrumit (-1):

Kati i pjesshëm nëntokës shfrytëzohet si depo magazinimi dhe ambient teknik elektrik. Akseset në të realizohen nga shkallë të brendshme dhe disa shkallë të jashtme që vijnë në perimetër të objektit, Kati është i ndriçuar nga dritare në tri faqe të tij. Problemet e drenazhimit kanë sjellë përmytje të herëpashershme të këtij kati, cka e ka bërë këtë hapësirë të dalë jashtë funksionit normal. Një pjesë e dritareve janë të mbyllura dhe disa janë të thyëra. Lagështia e shfaqur në paretet e mureve, mungesa e suvasë, pllakave të shtrimit dhe mungesa e mirëmbajtjes ka sjellë një degradim të rëndë të kësaj hapësirë. Imazhet e mëposhtme tregojnë gjendjen aktuale të katit nëntokë të Muzeut Kombëtar të Arteve.



Figura 7. Pamje nga kati i nëntokës

Kati i përdhe (0)

Kati përdhe fillon me hollin kryesor në të cilin ndodhet recepsioni dhe biletaria.

Nëpërmjet hollit bëhet shpërndarja në sallën ekspozuese të përkohshme që ndodhet në shtesën e pasme në lindje, në bibliotekë e cila ndodhet në shtesën anësore në veri dhe në administratë. Hyrja kryesore e publikut përdoret gjithashtu si hyrje për administratën dhe hyrje për veprat, duke qenë se mungojnë hyrjet e dedikuara për to.

Në katin përdhe, në një hapësirë të improvizuar midis objektit kryesor dhe atij shtesë, janë vendosur fondi i skulpturave, jashtë çdo standarti për vendosjen dhe ruajtjen e veprave.

Sipërfaqja e dedikuar për sipërfaqjen është shumë e vogël krahasuar me kapacitetin e punonjësve dhe funksioneve që duhet të ketë një muze arti.

Aktualisht nuk ka një hapësirë të dedikuar për hyrjen dhe depozitimin e përkohshëm të veprave që sillen në galeri. Gjithashtu nuk ka një qëndër të mirëfilltë dixhitalizimi për veprat, as ashensor për transportimin e veprave në kate. Një hapësirë minimale prej 50 m² është improvizuar për laborator, i cili përdoret edhe për pikturën edhe për skulpturën. Laboratori ka fasadë xhami në perëndim dhe nuk është i hijëzuar, çka vëshirëson shumë kushtet e punës dhe shpesh here dëmton veprat. Gjithashtu atij i mungon dhoma e disinfektimit, raftet metalike, aspiratori etj. Brenda hapësirës në fjalë ndodhen edhe dy poste pune.



Figura 8.9. Laboratori i restaurimit

Aktualisht GKA ka një sipërfaqe fondi rreth 550 m², nga të cilat rreth 200 m² zënë skulpturat dhe 350 m² pikturat dhe grafika. Hapësirat në të cilat është vendosur fondi janë totalisht të improvizuara, nuk plotësojnë kushtet fizike të ruajtjes së veprave dhe kushtet e sigurisë. Mbivendosja e veprave pa strukturë organizimi ka qënë e detyruar për shkak të sipërfaqes së pamjaftueshme të vënë në dispozicion për fondin. Fondi është i vendosur në katër zona të ndryshme të objektit në katin përdhe dhe në katin e parë.

Shënim: Imazhet e hapësirave të fondit ekzistues nuk mund të publikohen për arsye sigurie.



Figura 10. Pamje nga kati përdhe

DysHEMEJA prej mermeri në holl ka pësuar plasaritje të ndjeshme, ndërkohë që tavani me rriga 10x10 duket i amortizuar.



Figura 11.12 Demtimet e shfaqura ne dysHEME

Kati i parë dhe i dytë

Në katin e parë dhe të dytë të objektit kryesor vendosen sallat e ekspozimit të përhershme. Sallat e ekspozitave nuk kanë sistem të kontrolluar të ajrit dhe temperaturave, çka sjell demtim serioz të veprave të ekspozuara. Vetratat e objektit janë me profile druri ose alumini me ura termike dhe xham tek, sistem ky që sjell probleme për ruajtjen e temperaturës së brendshme.

Një hapësirë prej rreth 200 m², në katin e parë të objektit shtesë është improvizuar për fondin e pikturave, një hapësirë kjo e improvizuar jashtë cdo standarti për vendosjen dhe ruajtjen e veprave.

2.1.3. Fasada

Fasada perendimore:

Për veshjen e kesaj fasade janë përdorur disa materiale. Në katin përdhe një pjesë të sipërfaqes e zënë vetratat , te cilat janë me profile duralumini.

Zona e hyrjes kryesore është e veshur me gurë natural ngjyrë të bardhë, kollonat janë veshur me pllaka mermeri dhe pjesa tjetër e fasades është me suva e lyer me bojë. Mbulesa e hyrjes kryesore është e veshur me mozaik me dimensione 5x5 ngjyrë kafe.

Në katin e parë dritaret janë me profile druri , kanë lartësi dysHEME-tavan dhe janë të ngushta me gjerësi 60cm. Materialet që janë përdorur për veshjen e fasadës janë mozaik me dimensione 5x5cm, ngjyrë të bardhë por janë dëmtuar nga pluhurat dhe ujrën e shiut, si rrjedhojë është shfaqur lagështia. Pjesa më e madhe e sipërfaqes së këtij mozaiku është e demtuar ose mungon. Në katin e dytë fasada është e veshur me mozaik 5x5cm ngjyre kafe dhe një pjesë e mirë e pllakave janë të shkëputura.



Figura 13. Gjendja ekzistuese e fasadës kryesore. Dalja e tubacioneve dhe shkeputja e mozaikut.



Figura 14. Problematikat e evidentuara ne fasaden perendimore

Fasada veriore:

Në këtë fasadë dritaret janë profil duralumini, të vendosura linearisht në pjesën e sipërme të fasadës dhe vertikalisht në pjesët anësore. Një zonë është e veshur me mozaik 5x5cm ngjyrë të bardhë, pjesa më e madhe e së cilës është e demtuar dhe pjesa tjetër është me suva dhe bojë ngjyrë të bardhë.

Kjo fasadë shfaqet në gjendje të degraduar si mungesë e mirëmbajtjes dhe lagështirës në muret perimetrale.



Figura 15.16 Gjendja ekzistuese e fasadës veriore. Evidentimi i degradimit të materialeve dhe lagështisë.




Figura 17. Problematikat e evidentuara ne fasaden veriore

Fasada jugore:

Në këtë faqe të objektit kemi dëmtimet më të mëdha të fasadës, sepse është më e ekspozuar nga dielli dhe shirat. Në këtë fasade kemi pak siperfaqe me dritare pasi shumica e tyre janë mbyllur. Pjesa e veshur me mozaik 5x5cm ngjyrë të bardhe, shumica e mozaikeve janë shkeputur dhe janë të thyer. Fasa jugore e shtesës e cila është e veshur me suva është e demtuar nga lageshtia.



Figura 18.19. Gjendja ekzistuese e fasadës jugore. Evidentimi i vegetacionit dhe shkëputjës së mozaikut ne figurën majtas dhe lagështisë në fasadë në figurën djathtas.




Figura 20. Problematikat e evidentuara ne fasaden jugore

Fasada lindore:

Kjo faqe e objektit është e veshur me mozaik 5x5cm, kryesisht në katin e parë dhe të dytë. Dritaret janë me profil druri. Zona e hyrjes së administratës është e mbuluar nga vegetacioni. Shkallët e hyrjes janë me pllaka mermeri, të cilat janë të dëmtuara dhe pjesa e suvasë është plasaritur nga lagështia. Në këtë zonë gjithashtu janë të vendosur dhe pajisjet e kondicionimit, të cilat demtojnë estetikisht fasadën dhe bëhen dhe shkas për grumbullimin e papastërtive dhe ndotjes së fasadës.

Kjo fasadë është pjesërisht e dukshme pasi në të është bashkëngjitur objekti shtesë.



Figura 21.22. Gjendja ekzistuese e fasadës lindore. Evidentimi i vegjetacionit dhe vendosjes së pajisjeve.




Figura 23. Problematikat e evidentuara ne fasaden jugore

2.1.4. Konstruksioni

Projekti ekzistues i strukturave të godinës së "Muzeut Kombëtar të Arteve të Bukura" ose "Galeria Kombëtare e Arteve" mban datën e vitit 1974.

Struktura mbajtëse e godinës ekzistuese është me skelet betonarme. Muret e tullës nuk janë mbajtëse por thjesht shërbejnë për ndarjen e ambjenteve dhe realizimin e fasades së jashtme. Nga pikëpamja strukturore objekti nuk është i rregullt në plan dhe në lartësi. Soletat janë prej betoni të armuar në disa zona monolite dhe pjesa më e madhe e struktures mbulohet me soleta të parapërgatitura me bira.

Themelet e godinës janë konceptuar si themele të vecuar tip plinta të lidhur pjesërisht me trarë themeli. Tabanet e plintave janë pozicionuar në disa kuota. Objekti në një pjesë të tij ka një kat nëntokë. Murët perimetrale të bodrumit janë realizuar me butobeton.

Niveli i njohjes më në thellësi të strukturës mbështetet në materialet grafike të projektit fillestar, vlerësimin vizual gjatë vizitave në godinën e Galerisë së Arteve dhe vlerësimin e problematikave të ngritura në raportet shoqëruese.

Vlerësimi i strukturave të objektit ekzistues mbështetet në materialin grafik të vënë në dispozicion nga Ministria e Kulturës dhe vëzhgimet në objekt të problematikave të ngritura. Materialet grafike janë projekti konstruktiv dhe relacioni gjeologjik fillestar i përdorur në projektimin e godines ekzistuese.

Projekti konstruktiv ekzistues është i plotë por mungojnë relacionet llogaritëse dhe shënimet teknike përmbajnë vetëm të dhënat për rezistencat e betonit dhe të celikut.

Planet e themeleve dhe soletave shpesh janë shumë skematike të pa plotësuar me dimensionimin e elementëve në prerje. Kjo bën që leximi i permasave të elementëve strukturalë të vështirësohet.

Më poshtë paraqiten plani i themeleve dhe planet e soletave sipas projektit ekzistues.




Figura 24. Plani i themeleve, pjesë e projektit origjinal.




Figura 25. Plani i mbuleses së bodrumit, kuota -0.05, pjesë e projektit origjinal

2.2. NDËRHJET E PROPOZUARA

2.2.1. Plansistemimi

Brenda kufirit të zonës së zhvillimit do të propozohen ndërhyrje në sistemimin e jashtëm.

Fillimisht vendi do të pastohet nga kioskat dhe objektet shtesë. Sipas projektit të rikonstruksionit, do të realizohen gërmimi dhe mbushja e dheut për nivelimin e ri. Do të realizohet plani i ri për drenazhimin e ujrave. Shkallët e brenda zoës së zhvillimit do të rindërtohen sipas projektit të ri. Pllakat e pjeshshme të shtrimit do të zëvendësohen me pllaka të reja të cilat do të shtrohen uniformisht për qark gjithë objektit. Sipërfaqet e gjelbërta që do të eliminohen për shkak të ndërtimit të ri, do të zëvendësohen në një sipërfaqë 3-4 herë më të madhe.



Figura 26. Ndërhyrjet në plansistemim

2.2.2. Planet

Kati i podrumit (-1):

Kati nëntokë do të pastrohet nga mbetjet dhe lagështia. Një pjesë e mureve të brendshme do të prishen sipas projektit të ri. Shtresat e dëmtuara të dyshemesë do të zhvishet dhe do të krijohet një shtrim i ri me pllakë gres për ambient teknik. Dritaret e podrumit në fasaden perëndimore dhe jugore do të zëvendësohen me të reja, kursë dritaret në fasadën lindore do të mbyllen. Dera e jashtme do të zëvendësohet me derë të re metalike. Shkallët e jashtme të cilat të cojnë në podrum do të mbyllen me grilë metalike e cila do jetë e hapshme vetëm në aksesimin e derës.

Kati përdhe (0):

Kati përdhe do riformulohet duke iu rikthyer sa më afër projektit origjinal dhe përshtatur me kërkesat mbi muzeun e ri. Kështu, objekti kryesor ruhet dhe restaurohet, ndërkohë që shtesa e pasme propozohet të prishet. Hapësira e cila është përshtatur si bibliotekë do të hapet duke u rikthyer në holl të jashtëm si në projektin fillestar. Pas prishjes së objektit shtesë në lindje i cili i është bashkëngjitur fasadës lindore, do krijohet vetratat e reja në këtë fasadë siç ka qenë në projektin fillestar. Shkallët e jashtme në fasadën lindore të prishen duke iu përshtatur riformulimit të ri arkitektonik.

Në këtë kat do të ketë përfundim të kolonave sipas studimit të projektit konstruktiv. Muret e brendshme të administratës do prishen dhe hapësira do të përshtatet me funksionet e

reja. Holli kryesor do të ruhet dhe rifiniturat e brendshme si dysHEMEJA me mermer dhe tavani me riga do të zëvendësohen me të reja të cilat janë në dukje të njëjta me origjinalet. Të gjitha dritaret dhe vetratat do të zëvendësohen me të reja me transmetim të ulët të nxehtësisë, por duke ruajtur formen dhe ngjyrën e modelit origjinal.

Kati i parë (1):

Kati i parë i objektit kryesor do vazhdojë të funksionojë për ekspozim, kështu ndërhyrjet në këtë kat do jenë kryesisht në shtresat e dyshemesë dhe tavanit. Sallat e ekspozimit do të shtrohen sërish me parket kurriz peshku, ndërsa hollet me pllakë mermeri. Tavanet e reja gipsi do të vendosen pas instalimit të sistemit të ri të ajrimit dhe ngrohje /ftohjes. Tavani i gipsit do të jetë me parametrat e përshtatshëm akustik. Dritaret ekzistuese do të zëvendësohen me të reja duke ruajtur të njëjtën formë, madhësi, ngjyrë por me parametra më të mirë fizik. Muret e brendshme të gipsit të cilat janë shtuar gjatë viteve do të hiqen duke rikonfiguruar hapësirën e brendshme.

Në këtë kat do të bëhet lidhja me objektin e i përmes urave, kështu që do të ketë prishje të murit në atë zonë.

Kati i dytë (2):

Kati i dytë i objektit ekzistues funksionon për salla ekspozimi dhe sikunder kati i parë, ai do të lidhet me objektin e propozuar nëpërmjet urave. Në këtë kat do të ketë prishje të muraturës në pikat e lidhjes me objektin e ri. Gjithashtu, sistemi i ri i ajrimit do të kushtëzojë krijimin e taveve të reja gipsi. DysHEMEJA do të zëvendësohet me dysHEME të re, parket druri kurriz peshku, i ngjashëm me parketin origjinal.

Tarraca (2):

Fillimisht do të realizohet sistemi i ri i kullimit të ujrave në tarracë. Për të përmirësuar performacën energjitike të ndërtesës do realizohet shtresëzim i ri i tarracës duke siguruar termoizolim dhe hidroizolim optimal. Dritaret tavanore "Skylight" do të zëvendësohen me dritarë të reja me xham translucent që merr dritë vetëm në veri, ndërsa në jug paret do të jetë opak.




Figura 27. Ndërhyrjet në tarracë

Shkallët

Kafazi i ashensorit i vendosur vitet e fundit i mbetur jo funksional do të prishet dhe në këtë hapësirë do të vendosen shkallët e emergjencës për godinën ekzistuese.

2.2.3. Restaurimi i fasadave

Objekti kryesor i cili është Monument Kulture i Kategorisë II, shquhet për karakteristikat e veçanta të pamjes së jashtë, si e tillë fasadat e objektit do të nënshtrohen restaurimit duke rikthyer vlerat arkitektonike kësaj godine.

Fasada perëndimore

Fasada perëndimore është fasada kryesore e objektit, ndaj edhe trajtimi arkitektonik i saj është më i spikatur. Paretet e veshura me Mozaik Venecian për shkak të mungesës në masë të madhe që kanë pësuar dhe demtimit të ndjeshëm të pllakave të mbetura, është menduar të zëvendësohen tërësisht me pllaka të reja të cilat do të kenë të njejtën pamje si origjinali. Veshja me pllaka Teresino vendi do të zëvendësohet vetëm në pjesët ku mungon. Pllakat veshese do të lahen me tretësirë 10% alkool me ujë në pjesët ku ka papastërti të lehta dhe me rërë karboni në pjesët ku papastërtitë janë më të rënda. Pjesët e veshura me suva të cilat paraqesin shfaqje të patinave biologjike, do të pastohen, do të eliminohet lagështia dhe do të realizohet suvatim i ri dhe lyerje me bojë duke ruajtur ngjyrën origjinale.

Dritaret ekzistuese do të zëvendësohen me dritare të reja të cilat kanë performacë të lartë termike dhe ruajnë të njejtën formë, madhësi, ngjyrë si dritaret origjinale. Pajisjet e kondicionimit dhe kabllot që janë të dukshme në fasadë do të hiqen.




Figura 28 Ndërhryjet restauruese në fasadën perëndimore

Fasada jugore

Në fasadë jugore do të eliminohen bimët kacavjerresë të cilat mbulojnë fasadën.

Paretet e veshura me Mozaik Venecian për shkak të mungesës në masë të madhe që kanë pësuar dhe demtimit të ndjeshëm të pllakava të mbetura, do të zëvendësohen tërësisht me pllaka të reja të cilat do të kenë të njejtën pamje si origjinali. Kati i fundit do pastrohet nga shtresa hidroizoluese dhe do të vishet me pllaka të reja Teresino vendi si në fasadën perëndimore.

Dritaret të cilat janë mbyllur me mur, do të rihapen dhe do të plotësohen me dritare të reja.

Dritaret ekzistuese do të zëvendësohen me dritare të reja të cilat kanë performacë të lartë termike dhe ruajnë të njejtën formë, madhësi, ngjyrë si dritaret origjinale.

Pajisjet e kondicionimit dhe kabllot që janë të dukshme në fasadë do të hiqen. Kafazi i ashensorit i shtuar vitët e fundit do të priset.




Figura 29. Ndërhryjet restauruese në fasadën jugore

Fasada lindore

Fasada lindore do të dal në pah pas prishjes së objektit shtesë i cili i është bashkëngjitur.

Paretet e mureve të cilët kanë humbur veshjen me pllaka Teresino Vendi do rivishen.

Në katin përdhe do të rihapen muret për të vendosur vetratat e xhamit sic kanë qënë në projektin fillestar.

Dritaret të cilat janë mbyllur me mur, do të vishen me xham pasqyrues duke ruajtur funksionalitetin e interiorit të sallës ekspozuese. Dritaret ekzistuese do të zëvendësohen me dritare të reja të cilat kanë performacë të lartë termike. Kafazi i ashensorit i shtuar

vitet e fundit do të prishet dhe kjo hapësirë do të shfrytëzohet për shkallën e emergjencës.




Figura 30 Ndërrhyrjet restauruese në fasadën lindore

Fasada veriore

Muri i shtuar në katin perdhe do të prishet dhe fasada do të rikthehet si në projektin fillestar. Paretet e veshura me Mozaik Venecian për shkak të mungesës në masë të madhe që kanë pësuar dhe demtimit të ndjeshëm të pllakave të mbetura, do të zëvendësohen tërësisht me pllaka të reja të cilat do të kenë të njëjtën pamje si origjinali. Veshja me pllaka Teresino Vendi do të zëvendësohet vetëm në pjesët ku mungon. Pllakat veshese do të lahen me tretësirë 10% alkool me ujë në pjesët ku ka papastërti të lehta dhe me rërë karboni në pjesët ku papastërtitë janë më të rënda. Dritaret ekzistuese do të zëvendësohen me dritare të reja të cilat kanë performacë të lartë termike dhe ruajnë të njëjtën formë, madhësi, ngjyrë si dritaret origjinale.




Figura 31. Ndërrhyrjet restauruese në fasadën jugore

3. ZHVILLIMI I RI

3.1. KONCEPTI PËR "MUZEUN E RI"

Konteksti i ndërlikuar i mjedisit të Muzeut ishte preokupimi qendror i projektimit në fazën e parë: si ta zgjeroni Parkun duke ftuar qytetin? Si ta respektojmë dhe ta ruajmë GKA duke krijuar një prani të rëndësishme prane Qendres? Si ta qartësojmë organizimin e Muzeut duke rritur madhësinë dhe kompleksitetin e saj? Zgjidhja e miratuar ishte superpozimi i galerive të përkohshme (, të përhershme për të krijuar një kaskadë tipologjish shkallësh që te nxitin nga parku në qytet. Ne propozojmë të endemi bashkë në qytet, në park dhe në muze; zgjerimi është një zgjatje e të treve në të njëjtën kohë.

Ndryshe nga volumet e shprehura dhe veshjet e detajuara të objektit të vjetër, Zarfi i MKAB të ri përbëhet nga një lëkurë e ashpër metalike, një mbështjellje misterioze e cila nuk e kërkon vemëndjen në eksterierin e saj, por të shtyhen të eksplorosh në brendësi, edhe pikërisht aty, një sallë e madhe transparente e lartë 15 m, të fton të endesh në Artit.

Një sallë pritjeje e vërtetë urbane, në zemër të jetës së muzeut. Ajo shërben si një ndërfaqe në kontekstin urban për shumë funksione publike të muzeut. Për shkak të rëndësisë së saj, kjo hapësirë mund të organizojë ngjarje të mëdha publike. Me pikëpamjet e korsive të trafikut dhe galerive të përhershme dhe të përkohshme, ajo menjëherë drejton vizitorët jo vetëm në muze, por edhe në vend. Ai paraqet një seri portash për galeritë, oborrin dhe auditorin e ëorkshop. Shkalla e saj e madhe shkon rrjedhshëm drejt pavioneve të reja të lidhura me pavionet ekzistuese.

Qartësia e trafikut dhe muzeografisë është thelbësor në formën e ndërtesës. Përgjatë pedonale një seri programesh - shtëpi, kafene, dyqane, shtigje dhe kopshte, përzihen për të ofruar trajektore të shumta. Në kundërshtim me qetësinë introspektive të galerive, kjo trajektore është një përzierje e artit, aktiviteteve dhe shëtitjeve publike. Përgjatë kësaj rruge, pikëpamjet e orkestruar e lidhin vizitorin me parkun dhe pjesën tjetër të kompleksit. Brenda, mezzanines dhe ballkone dal në galeritë e përkohshme dhe të përhershme. Kjo seri e hapësirave me forma dhe atmosfera të ndryshme sjell vizitorët, si rastësisht, në pjesën tjetër të kompleksit.

Atriumi 15 metra i lartë, është një nga hapësirat më të shquara të kompleksit.

Përmblytur me dritë natyrore nga fasada e tejdukshme, ky atrium lidh vizualisht të gjitha funksionet e muzeut.

Larg nga të qenit "lidhës" shkalla, ndryshe nga arterie, ben një qark të vazhdueshëm nëpër galeritë e ndryshme: ajo është pjesë e një, rrugë koherente lineare me pamje mbi park, vendi sala e perkohshme, Sallat e perhershme dhe qasje në tarrace. Galeritë atmosferë, të favorshme për soditje, të shquar nga pjesa tjetër e muzeut. organizimi i tyre lineare, zgjedhja e materialeve dhe prania e dritës natyrore të kombinohen për të luftuar lodhjen muze.

Galeritë janë projektuar në një kornizë strukturore prej 5 metrash që jo vetëm që lejon fleksibilitet të madh në organizimin e ndarjes së galerisë së perkohshme, por gjithashtu do të lehtësojë çdo riorganizim të galerive të përhershme. Ky i fundit, i cili, tavan,do lejojnë ekspozimin me chords krijuar një ndriçim homogjen e duke fshehur pajisje të ndryshme teknike. Detajet e hollësishme arkitekturore, tavanet e ndriçuara dhe korniza me drurë përcaktojnë sfondin dhe lënë, dhe me sqimë, vendin e muzeologjisë për të treguar historinë e Artit. Duke i bërë jehonë tavaneve, dyshemetë mbarojnë në dru, duke krijuar një atmosferë të qetë për përvojën e artit. Tradicionalisht, muzetë janë "fortesa" të artit që izolojnë vizitorin nga bota e jashtme dhe kalimin e kohës.

Hyryja e administratës realizohet në fasadën e re lindore, në pjesën e pasme të objektit të ri. Nëpërmjet një holli dhe blloku shkallë-ashensor të pozicionuar në këtë objekt realizohet levizja e punonjësve për në katin e katër, ku janë të pozicionuar zyrat kryesore të administratës.

Hyryja për veprat gjithashtu poziconet në pjesën e pasme të objektit të ri, në lindje. Pasi hyjnë, veprat qëndrojnë në një hapësirë të dedikuar si qëndrim i perkohshëm ku përshtaten me temperaturat e ambientit ,më pas kalojnë në dhomën e regjistrimit. Pasi kalojnë regjistrimin veprat mund të shkojnë në laborator, në sallat e ekspozitave ose në fond. Laboratori vendoset në katin përdhe në krah të dhomës së regjistrimit, kurse nëpërmjet ashensorit të veprave ato dërgohen në sallat e ekspozitave në katet e mësipërme ose në fond, i cili vendoset në katin nentokë. Hapësira e dedikuar për fondin në katin nentokë do të ketë të gjithë parametrat e nevojshëm fiziko-ambiental për kategorinë e veprave në të cilat ato do të organziohen. Kryesisht veprat ndahen në 2D dhe 3D, por sipas specifikave përkatëse ato ndahen në ambiente të vecanta sipas nënkategorive përkatëse.

Ambientet teknike të muzeut, shumë të nevojshme për funksionimin e tij zënë një hapësirë të konsiderueshme në propozimin e ri. Ato pozicionohen kryesisht në katin e nentokës dhe në tarracën e objektit, por gjithashtu në çdo kat ka një hapësirë të dedikuar për ambientin mekanik dhe elektrik.

Objekti mendohet të ketë minimalisht dy dalje emergjente, një i pozicionuar në objektin e ri dhe një në objektin ekzistues. Shkallet e emergjencës në objektin e ri do të jenë të mbyllura me stukturë b/a, kurse në objektin ekzistues mendohen të jenë shkallë të hapura me strukturë metalike, të pozicionuara jashtë objektit në krahun jugor të tij.

3.2. ZGJIDHJA URBANE

3.2.1. Plansistemimi dhe ambientet rekreative

Në sajë të skemës sonë të re urbane, krijohet një arterie e re që lidh unazën e madhe me unazën e vogël nëpërmjet kalimit përmes një aksi artistik. Rruga e re këmbësore do të lidhi Shëtitoren "Murat Toptani" me Bulevardin "Zhan D'Ark" dhe Bulevardin "Deshmorët e Kombit". Një aks i cili rrit eksponencialisht bashkëveprimin midis publikut dhe artit përfaqësues të tij. Rritja e hapësirave publike, tarracave të gjelbërta dhe hapësirave rekreative janë një pikë e fortë e këtij projekti.

Objekti do të ketë akses nga hyrja veriore dhe jugore, hyrje këto të cilat shoqërohen me hapësira të gjera ftuese.

Në hyrjen veriore, shtrihen dy platorma të gjelbërta me sipërfaqje rreth 650 m², të shoqëruara me një basen ujor dhe kënde pushimi për vizitorët.

Në hyrjen jugore, platforma nën konsol shërbën si një hapësirë interaktive urbane për zhvillimin e një sërë aktiviteteve me funksion kulturor dhe argëtues.





Figura 32 Plansistemimi i propozuar

3.2.2. Shtrimi

Pllakat e shtrimit do të jenë në dy tekstura të dallueshme: pllaka guri për rrugen e shëtitorës e cila do lidhi akset e lëvizjës dhe pllaka e shtrimit prej mermeri e cila mbulon sheshet hyrjet dhe depërtimin në brendesi të hollit, duke e trajtuar këtë të fundit si hapësira tranzitore midis interiorit dhe eksterierit.



Lloji: Pllakë Granit i errët
Gjatësi: 84cm
Gjerësi: 40cm
Trashësi: 3cm
Fugë: 0.5cm
Densiteti: 28kg/m³

Specifikim: Pllakë gri e errët graniti.
Ky lloj materiali është i përshtatshëm për shtrim në ambiente të jashtme dhe të brendshme.

Figura 33. Pllakë shtrimi

3.2.3. Gjëlberimi

Duke qenë se Muzete janë tempuj arti, mjedisi duhet të kushtëzojë qetësi dhe refleksion. Për këtë nevojiten sipërfaqe të gjëlberta të cilat në projektin tonë vijnë me një sipërfaqe mbi 600 m². Pemët janë përzgjedhur duke pasur parasyqsh karakterin e zonës dhe bimësinë lokale.




Figura 34. Pemet e propozuara

3.2.4. Mobilimi Urban

Hapësirat publike të propozuara nuk mund të jenë të shfrytëzueshme plotësisht nëse nuk do të kishte elemente të mobilimit urban. Kështu, është menduar që këto hapësira të plotësohen me stola pushimi, kosha mbeturinash, parkim për bicikletat të vendosur në hyrjen përfundimtare pranë rrugës kryesore.



Figura 35. Stol betoni

3.3. ZGJIDHJA NE PLAN

3.3.1. Skema funksionale

Propozohet riorganizimi total i hapësirës së brendshme dhe shtimi i kapaciteteve nëpërmjet krijimit të një volumi të ri. Shtrimi i kapaciteteve të godinës ka ardhur si kërkesë e Termave të References dhe studimit të hollësishëm që i është bërë objektit ekzistues duke evidentuar mungesat e tij. Propozohet që Muzeu i Arteve të Bukura në mënyrë që të plotësojnë funksionet e tij si një Muze Arti Kombëtar bashkëkohor të kompletohet me funksionet e mëposhtme:

A. Ambientet për Konservim Dixhitalizimin, e cila do të përmbajë:

- Hyrje e veçantë për veprat, hapësira për ngarkim-shkarkim dhe depozitim të përkohshëm; hapësire për pastrim, paketimin e tyre;
- Qendra e regjistrimit dhe fotografimit;
- Laboratorët e restaurimit për pikturën dhe skulpturës dhe anekset përkatëse;
- Ashensori për transmetimin e veprave;
- Fondi me kapacitetet e nevojshme dhe i kategorizuar në 2D dhe 3D.

B. Ambiente Ekspozuese të cilat do të përmbajnë:

- Ekspozitë e përkohshme
- Ekspozitë e përhershme

C. Ambiente Social-Kulturor të cilat do të përmbajnë:

- Auditorin
- Biblotekën
- Salla polivalente

D. Ambientet e Shërbimeve të cilat do të përmbajnë:

- Bar
- Dyqan suveniresh dhe librash
- Garderobë

D. Administrata e cila do të përmbajë:

- Zyra të hapura
- Zyra të mbyllura
- Zyra e drejtorit
- Salla e mbledhjes
- Kuzhina
- NHS

E. Ambientet Teknike të cila do të përmbajnë:

- Ambient teknik elektrik
- Ambient teknik mekanik
- Ambiente teknike kontrolli dhe sigurie
- Depo magazinimi

Këto funksione do të vendosen si në objektin ekzistues ashtu edhe në atë të ri, duke e trajtuar të gjithë hapësirën si një të vetme, por secila godinë do të ruaje gjuhën e saj arkitektonike duke reflektuar kohën në të cilën është ndërtuar.

3.3.2. Sipërfaqet e funksioneve ekzituese dhe atyre propozuese

Në tabelën e mëposhtme paraqiten në mënyrë të përmblëdhur sipërfaqet e funksioneve në objektin aktual dhe në atë propozuar.

Tablela 1

AMBIENTE	EKZISTUESE SIP M2	PROPOZIMI SIP M2
Konservim/dixhitalizim	95	320
Fondi	535	1513
Ekspozite	2450	3600
Administrate	330	650
Biblioteka	160	140
Aktivitete social-kulturore	30	515
Ambiente teknike , magazina	252	642
Sherbime	0	395
Holl ,shkalle-ash,koridore ambiente ndihmese	781	2284
	4633	10066

3.3.3. Hyrja dhe levizjet

Objekti ka tri hyje për publikun, një hyrje ceremoniale në objektin e vjetër dhe dy hyrje të reja në fasadën veriore dhe jugore të cilat të shpien në hollin kryesor.

Hyrja e personelit bëhet në fasadën e re lindore të objektit. Pas hyrjes, ka një holl për administratën dhe nëpërmjet ashensorit bëhet levizja e tyre në katin 2 ku ndodhet njësia e administratës.

Hyrja e veprave bëhet në fasadën lindore. Pasi hyjnë, veprat depozitohen në hapësirën e përkohshme. Nga këtu mund të shkojnë në laborator i cili ndodhet në katin përdhe, nëpërmjet ashensorit të veprave shkojnë në fond në katin -1 ose në sallat e ekspozitave.



Figura 36. Aksesit dhe funksionet në katin përdhe

Lëvizja në muze është e koordinuar por edhe fleksible. Shkallët që ndodhet në hollin kryesor mendohen të jenë transportuesi më i madh i lëvizjes vertikale për shpërndarjen e publikut në sallat ekspozuese si edhe në bibliotekë. Në ndihmesë do të jenë edhe dy ashensorët e publikut të vendosur në qendër të objektit.

Projektimi i muzeut ka krijuar mundësinë e lëvizjes pa barriera për personat me aftësi të kufizuara. Të gjitha shkallët e objektit duke filluar nga sistemi i jashtëm deri në katet e fundit, janë shoqëruar me panduse me pjerresë 6% për personat me aftësi të kufizuara. Gjithashtu ashensori i vënë në dispozicion të publikut ka hapësirat e përshtatshme edhe për lëvizjen PAK.

3.3.4. Ekspozimi

Sallat ekspozuese që kanë qënë në objektin ekzistues restaurohen dhe lidhen nëpërmjet urave me sallat e tjera që ndodhen në objektin e ri. Linjat e komunikimit midis sallave do të vendosen saktësishtë pas hartimit të linjës muzeore, por hapësirat e vëna në dispozicion janë fleksibile, ashtu sikurse edhe linjat e komunikimit midis tyre .




Figura 37. Komunikimi midis sallave të ekspozitave.

3.3.5. Administrata

Blloku qëndror i administratës ndodhet në katin e dytë dhe ka akses të vecantë. Përbëhet nga zyra individuale dhe open space. I gjithë perimetri është i rrethuar me vetratë xhami dhe pas saj vjen mbulesa metatlike perforimet e së cilës krijojnë mundësinë për marrjen e ndricimit natyral por në sasi të kufizuar, duke luajtur edhe rolin e hijëzuesve.




Figura 38. Komunikimi midis sallave të ekspozitave.

3.3.6. Konservim Dixhitalizimi

Veprat kanë një hyrje të dedikuar dhe pas saj një hapësirë për depozitim të përkohshëm. Më pas kalojnë në dhomën e regjistrimit dhe fotogramit. Nga këtu mund të shkojnë në laborator i cili ndodhet në katin përdhe, nëpërmjet ashensorit të veprave shkojnë në fond në katin -1 ose në sallat e ekspozitave.

Fondi i pozicionuar në katin -1 përbëhet nga fondi i pikturës dhe grafikes dhe Fondi i Skultures dhe Ikonografise. Aksesimi në të është i kontrolluar. Parametrat fiziko-ambientel në fond janë të kontrollura. I gjithë zarfi i godinës është i termoizoluar duke shmangur humbjet e nxehtësise.




Figura 39. Plani i katit nentoke. Fondi

Laboratori i restaurimit ndodhet në katin përdhe, në të njejtin bllok me hyrjen dhe regjistrimin e veprave. Ai ndahet në Restaurim Pikturë që ndodhet pranë fasades me drite natyrale dhe Restaurim Skulpturë që ndodhet më në brendësi të objektit ku ndricimi duhet të jetë i kontrolluar. Laboratori i Pikturës është i pajisur me dhomën e disinfektimit dhe hapësirën për vernikun. Te dyja hapësirat janë të pajisura me tavolina pune dhe lavaman. Sistemi i temperaturës dhe parametrave fizik janë të kontrolluar. Në tavane janë të instaluar aspirator gjirafë.

Dyshemeja është me pvc antibakteriale, muret të lyer me bojë plastike që pastrohet lehtë dhe me veti antibakteriale.




Figura 40. Plani i laboratorit

3.3.7. Ambientet kulturore

Në krah të hyrjes në katin përdhe pozicionet blloku "auditor-sallë polifunkionale", duke i dhënë të rinjeve një hapësirë më shumë për ndërveprim.

Nëpërmjet shkallave që vendosen në perimetër të fasadës, publiku akseson në katin -1 (për në auditor), ose nëpërmjet ashensorit që ndodhet në bllokun qendror (kryesisht për personat me aftësi të kufizuar.)

Auditori, ka një kapacitet prej rreth 200 personash dhe mund të përshtatet për një sërë eventesh. Tavani i tij është eliptik dhe i veshur me panel akustik të mikroperforuar. Të gjithë muret veshëse të auditorit janë me panele druri të përforuara, duke siguruar që sala të ketë parametrat e duhur akustik.

Shtrimi i tij është me mokat për të abosuruar zhurmat.




Figura 41. Prerje e auditoriumit

Salla ka dy dalje emergjente, njëra në katin -1 që funksionon edhe për personat me aftësi të kufizuar, e cila të orientojnë në bllokun qendror b/a, edhe tjetra nga kati përdhe ku nëpërmjet derës antizjarr dilet direkt në ambient të jashtëm.

3.3.8. Dyshemetë

Shtresat e shtrimit në projekt variojnë sipas funksionit dhe vendndodhjes dhe janë përcaktuara në fletët teknike detajet për secilin rast. Vlen të veçohet shtrimi i hollit kryesor i cili do të realizohet me të njëjtat pllaka si ambienti i jashtëm, pllaka mermeri 3cm.

Të gjitha sallat e ekspozitave do të shtrohen me parket, në sallat ekzistuese do të ruhet tekstura aktuale e parketit ndërsa në objektin e ri kjo teksture ndryshon.

Hollët dhe sheshpushimet do të shtrohen me pllaka mermeri.




Figura 42.43. Detaje te shtresave te dyshemese

3.3.9. Tavanet

Tavanet e përdorura në këtë projekt ndahen në dy klasa kryesore : tavane akustike dhe tavane të thjeshta gipsi.

Tavanet e mezzaninave dhe urave në hollin qendror do të jenë më veshje gipsi të perforuar për të ndihmuar akustiken në këtë holl gjigand. Gjithashtu edhe sallat e ekspozitave do të kenë tavane akustike por me një membranë të mikroperforuar e cila do të japë imazhin e një tavani të thjeshtë. Tavanet e sallës polivalente dhe auditorit do të jenë gjithashtu tavane akustike. Tavanet e koridoreve të brendshëm dhe të zyrave do të jenë tavane të thjeshtë gipsi.

3.3.10. Ndryçimi

Ndryçimi është një ndër parametrat kryesor të projektimit të muzeve. Për të shmangur ndryçimin e fortë natyral në objektin e ri na vjen në ndihmë veshja e perforuar, kurse në objektin e vjetër xhamat do të pajisen të gjitha me filtra UV protection. Në varësi të ndërtimit të linjës dhe interiorit të ekspozimit do të behen edhe mbylljet me grila ose parete të tjera opake të cilat do të kontrollojnë sasinë e ndryçimit natyral.

Skylight e objektit ekzistues do të zëvendësohen me xham translucent i cili merr dritë vetëm nga veriu.
fig.44




Figura 44. Detaje i skylight

Në interierin e sallave do të përdoren spote ndricimi të lëvizshëm me shina, kjo duke iu përshtatur fleksibilitetit të ndarjes së hapësirave. Fig.45



Figura 45. Ndricues të sallave të ekspozitës

3.3.11. Muret e brendshme

Muret e brendshme do të jenë me panele gipsi mjaft rezistent, me spesor 15.5mm të tipit pllakë diamant. Detajet e tipologjive të mureve janë paraqitur ne projektin teknik.

3.3.12. Mbrojtja ndaj zjarrit

Në këtë projekt i është kushtuar rëndësi të veçantë sigurimit të mbrojtjes ndaj zjarrit. Për secilin objekt ka dy dalje të sigurta emergjence; Në objektin e ri është vendosur në qendër blloku b/a i shkallës i cili ka hyrje në cdo kat dhe dalje të sigurt në katin përdhe. Në këtë bllok vendoset edhe një ashensor i mbrojtur për personat me aftësi të kufizuara.

Në godinen ekzistuese është vendosur një shkallë emergjente e jashtme metalike e cila aksesohet nga kati i parë, i dytë dhe tarraca. Duke qenë se objektet janë të lidhura me ura, secila nga daljet e sigurta të emergjencës mund të aksesohet edhe nga objekti tjetër.

Në zonat e mbrojtura dyert e emergjencës janë përcaktuar me rezistencë ndaj zjarrit R120

3.4. ZHVILLIMI VOLUMETRIK

3.4.1. Muret perimetrale

Muret e jashtme të objektit të ri do të jenë me sistem aquapanel, një sistem ky që siguron një mbështjellje të mirë termike dhe akustike të godinës.

Objekti është i veshur me mbulesë metalike të përforuar ngjyrë blu. Panelet e kësaj veshjeje kapen në segmente të soletës dhe mureve aquapanel. Në figurën 46 tregohet një detaj i fasadës së jashtme.

3.4.1. Vettratat e jashtme

Fasada është e trajtuar në dy tipologji xhamash: xhama translucent për salla të ekspozitave dhe xhama transparente për ambiente të tjera. Xhami i vishet objektit dhe mbulon soletën, duke e trajtuar të gjithë fasaden si një plan ku nuk ka segmentizime në kate. Fig.46

Në rastet kur vettratat vishet nga metali i perforuar, xhami kapet në brendësi të soletës. Fig 48




Figura 46.47. Detaje te fasadases




Figura 48. Detaje te fasadases

3.4.2. Tarraca

Tarraca e objektit të ri do të jetë tërësisht e shfrytëzueshme. Një pjesë e saj do të shfrytëzohet për vendosjen e pajisjeve mekanike, pra si ambient teknik dhe pjesa tjetër do të trajtohet si tarracë e shfrytëzueshme nga publiku. Publiku do të ketë mundësi të aksesojë tarracën nëpërmjet ashensorit qendror. Ne figuren e mëposhtme paraqitet një detaj i shtresëzimit të tarracës.




Figura 49. Detaje të shtresës së tarracës

3.4.3. Imazhe 3Dimensionale



Figura 50. Imazhe 3d



Figura 51. Imazhe 3d



Figura 52. Imazhe 3d



Figura 53. Imazhe 3d



Figura 54. Imazhe 3d



Figura 55. Imazhe 3d



Figura 56. Imazhe 3d



Figura 57. Imazhe 3D